

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                         |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Detaje/ Policia spanjolle godet rrjetin me tonelata kokainë drejtuar nga shqiptarët. Sekuestrohen 29 auto mjete luksoze                                                                                                                 |
| ADRESA  | <a href="https://piranjat.al/aktualitet/policia-spanjolle-godet-rrjetin-me-tonelata-kokaine-drejtuar-nga-shqi-i104942">https://piranjat.al/aktualitet/policia-spanjolle-godet-rrjetin-me-tonelata-kokaine-drejtuar-nga-shqi-i104942</a> |
| BURIMI  | piranjat.al                                                                                                                                                                                                                             |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                  |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 18 shtator 2026, 21:36:38 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 21:25:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | e5c03fc4a09d523bd4fe5f5a00f78743ca70769bfad2895d51a4f4b68e0bf12f |
| TEKSTI     | 0ac06b6f7fae7ff21a0ab57f302d47bb93d3f90297b6cdb9bc1daadae8973542 |
| PAMJA      | 1cde33cb548698eccef82c50718ce60f3ec1e6b4cbfe488a15c53c6385bc8495 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 09030f7aa9335f67f0eb8a170fda7f37dc6b41e93d04c8caa722197ccc794923                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 29fcf9b8b5be0730a486ab00126645ea98174f049f7b6a8e27a114acaae60ed3                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/09030f7aa9335f67f0eb8a170fda7f37dc6b41e93d04c8caa722197ccc794923>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash: [zbardhet skema e](#) "mollë shërr" dhe [në përndjekje](#) imagjinatës. Se unë, kur e plas bombën e [vendimit të](#) kontraktit, përplasja e drama që godasi [Hage, as në Beograd](#) Çiftimtare të Kosovës ka nis [edhe për trajtimin e](#) e Triportit në Vlorë, [diplomë rezultor](#)

AKTUALITET

## Detaje/ Policia spanjolle godet rrjetin me tonelata kokainë drejtuar nga shqiptarët. Sekuestrohen 29 automjete luksoze

Piranjat Përditësimi i fundit 18 Shtator 2026, 23:25



Tre persona janë arrestuar në Pilar de la Horadada, në kuadër të një operacioni madhor të Policisë Kombëtare spanjolle, i cili çoi në shkatërrimin e një rrjeti ndërkombëtar të trafikut të drogës, përgjegjës për transportimin e tonelatave kokainë në territorin spanjoll.

Të dyshuarit dyshohet se ishin të përfshirë në transportimin e ngarkesave të sekuestruara gjatë një hetimi ndaj një grupi kriminal shumë të organizuar, që vepronte mes Costa del Sol, Campo de Gibraltar, rajonit të Levantes dhe Katalonjës.

Në total, operacioni çoi në arrestimin e 15 personave, 12 prej të cilëve u lanë në burg me masën e arrestit në burg. Policia sekuestroi më shumë se 2.7 tonë kokainë, 800 gramë tusi, armë zjarri, automjete luksoze, para cash, bizhuteri, orë dhe asete financiare.

### Kontrolle të shumta në të gjithë Spanjën

Një nga fazat kryesore të operacionit u zhvillua më 10 prill 2026, kur efektivet kontrolluan banesa dhe një punishte në Málaga, Estepona, Marbella dhe Churriana.

Policia sekuestroi 1,434 kilogramë kokainë dhe 800 gramë tusi, së bashku me dy pistoletë, katër automjete dhe dy motoçikleta.

Në të njëjtën kohë, efektivet kontrolluan një vilë në Sant Just Desvern, pranë Barcelonës, e cila dyshohet se përdorej si bazë për magazinimin e drogës. Brenda garazhit u gjetën të fshehura edhe 1,351 kilogramë kokainë.

Tre anëtarë të tjerë të dyshuar të organizatës u arrestuan në Pilar de la Horadada gjatë ditëve në vijim. Hetuesit besojnë se të tre ishin të lidhur me transportimin e ngarkesave të sekuestruara.

### Kokaina transportohej me rrugë drejt veriut

Sipas Policisë Kombëtare, rrjeti përbëhej kryesisht nga shtetas shqiptarë me bazë në Costa del Sol. Ai dyshohet se ishte i specializuar në magazinimin dhe transportimin në rrugë të sasive jashtëzakonisht të mëdha të kokainës.

Hetuesit besojnë se droga sigurohej nga organizata kriminale të lidhura me trafikun e kokainës nga Kolumbia dhe futej në Spanjë përmes Algeciras dhe Campo de Gibraltar.

Më pas, rrjeti i magazinonte ngarkesat përpara se t'i transportonte drejt veriut të Spanjës. Sipas hetuesve, qëllimi ishte kalimi i kokainës përtej kufirit francez, për t'u shpërndarë më pas në të gjithë Bashkimin Evropian.

Policia identifikoi udhëtime të shpeshta mes Costa del Sol, Campo de Gibraltar, Madridit, rajonit të Levantes dhe Katalonjës. Disa prej anëtarëve udhëtonin qindra kilometra, qëndronin në destinacion vetëm për disa minuta dhe më pas ktheheshin menjëherë.

Këto lëvizje u mundësuan hetuesve të identifikonin strukturën e organizatës dhe të përcaktonin rolin e dyshuar të secilit anëtar.

Gjatë muajit prill, efektivet monitoruan një kolonë automjetejsh luksoze që përshkoi më shumë se 2,000 kilometra drejt Huelvës dhe u kthye brenda së njëjtës ditë. Disa prej automjeteve dyshohet se arritën shpejtësi mbi 200 kilometra në orë.

### Masa të sofistikuara sigurie

Policia e përshkroi organizatën si shumë të specializuar dhe anëtarët e saj si potencialisht të rrezikshëm.

Rrjeti dyshohet se kishte krijuar biznese që merreshin me automjete luksoze dhe përdorte automjete me qira të pajisura me targa të përkohshme, të cilat nuk shfaqeshin në disa prej databazave policore.

Hetuesit zhbuluan gjithashtu kontrata të dyshuara fiktive të lidhura me persona që shërbenin si ndërmjetës. Persona me burime të kufizuara financiare dyshohet se nërdorëshin në të marrë me qira

ose për të regjistruar prona ku magazinohet droga, duke e bërë më të vështirë lidhjen e këtyre ambienteve me drejtuesit e organizatës.

Gjatë disa udhëtimeve dyshohet se përdorshin deri në gjashtë automjete, disa prej të cilave shërbenin për të zbuluar praninë e policisë dhe për të mbrojtur automjetin që transportonte drogën.

#### **Sekuestrohen pasuri luksoze**

Përveç lëndëve narkotike dhe armëve të zjarrit, policia sekuestroi 29 automjete luksoze dhe bllokoj edhe tetë të tjera.

Efektivët sekuestruan gjithashtu më shumë se 13,800 euro cash, bizhuteri dhe orë me vlerë, kriptomonedha, llogari bankare dhe produkte të tjera financiare që dyshohet se ishin të lidhura me aktivitetin kriminal.

Operacioni vijoi gjatë gjithë verës, ndërsa policia gjurmonte të dyshuarit që ishin larguar nga Spanja ose ishin fshehur.

Nga 15 personat e arrestuar gjatë hetimit, 12 u urdhëruan të qëndronin në paraburgim pas paraqitjes së tyre përpara gjykatës. /PiranjatNews/

## **Artikuj te sugjeruar**

AKTUALITET 18 Shtator22:13

### **Vlorë/ Zjarr në kuzhinën e një restoranti në Skelë, flakët përfshijnë garazhin nëntokësor**

Një zjarr ka rënë në kuzhinën e një restoranti në Skelë, ndërsa flakët kanë përfshirë edhe gara...

AKTUALITET 18 Shtator21:49

### **Kush është 42-vjeçarja nga Durrësi që u përplas për vdekje nga kamioni i plehrave para syve të së bijës**

Një ngjarje tragjike ka ndodhur mëngjesin e së premtes në San Donà di Piave, pranë Venecias, ku një 42-vjeçare shqip...

AKTUALITET 18 Shtator20:32

### **Rruga Milot-Balldren, sërish hija e Ballukut në tenderin 365 milionë euro, fitues kompania nën hetim nga SPAK**

Rreth 365 milionë euro për 35 vjet. Kjo është vlera e parashikuar e koncesionit Milot-Balldren, rruga 17 kilometra e gjatë që do t...

AKTUALITET 18 Shtator20:23

### **Nga TikTok-u te “gara e vdekjes”, si humbën jetën 3 të rinjtë shqiptarë në Greqi**

Detaje të reja kanë dalë në dritë për aksidentin e rëndë të ndodhur në Glyfada të Athinës, ku humb&e...

AKTUALITET 18 Shtator18:06

### **E rëndë në Skrapar! Foshnja transportohet drejt Traumës, dyshohet se ka dëmtuar dorën me grirëse mishi**

Një foshnje 1-vjeçare është transportuar me helikopter drejt Spitalit të Traumës në Tiranë, pasi dyshohet se ka dë...

AKTUALITET 18 Shtator17:23

### **E rëndë në Itali/ Po shoqëronte vajzën për në shkollë, 42-vjeçarja shqiptare përplasat për vdekje nga kamioni**

Një aksident i rëndë ka ndodhur në mëngjesin e sotëm në San Donà di Piave, pranë Venedikut, ku 42-vjeçarja...

AKTUALITET 18 Shtator17:13

### **Alket Rizai ka hyrë në Shqipëri? Policia e Shtetit: Nuk kemi informacion zyrtar**

Pas pesë ditësh kërkimesh nga autoritetet greke, nuk ka ende asnjë gjurmë të Alket Rizait, i cili u arratis pas përfundimit t...

AKTUALITET 18 Shtator17:04

### **Detaje/ Abuzimi i 12-vjeçares në Tiranë, 29-vjeçari pranon se kreu marrëdhënie me vajzën e dajës**

Detaje të reja kanë dalë në pah nga ngjarja e rëndë që dje shokoi mbarë opinionin publik pasi dy të rinj u vunë...

AKTUALITET 18 Shtator16:56

### **Revolucioni Flamingo/ Eurodeputetët kërkojnë hetim ndaj Metës pas pezullimeve masive të llogarive në rrjetet sociale**

Eurodeputetët kërkojnë hetim ndaj Metës pas pezullimit masiv të llogarive që raportnin për protestat në ShqipëriLi...

AKTUALITET 18 Shtator16:30

### **Përfshihet nga flakët një sipërfaqe toke në zonën e Katund Sukthit në Durrës, ndërhyjnë zjarrfikësit**

Një zjarr ka përfshirë pasditen e kësaj të premtjeje një sipërfaqe toke në zonën e Katund Sukthit, në Durr&eu...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 18 Shtator

### ["Nëna e fëmijëve të mi, dashuria ime sot na la"...](#)

Loer Kume, deputet i Partisë Socialiste për Durrësin dhe prozator e eseist i njohur, ka njoftuar mesditën e kësaj të premte ndar...

BOTA 18 Shtator

### [Trump: Ka pasur përparim të madh drejt bazës us...](#)

Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, deklaroi të enjten se ka pasur "përparim të madh" drejt krijimit të një baze ush...

BOTA 18 Shtator

### [Ngjarje e rëndë në aeroport, avioni përfshihet ...](#)

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në Libi, ku një avion i cili sapo ishte ulur, u përfshi nga flakët. Avioni privat Cessna Ci...

INVESTIGIME 18 Shtator22:42

### ["Dua 120 mijë euro"/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit](#)

Jemi në Tiranë, në rrugën e Durrësit, aty ku një apartament është kthyer në "mollë sherri" dhe ka ...

## video




## PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



## PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1



“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.